

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (RISHPALLJE)

për plotësimin e vendit të punës me të dhënat si në vijim:

Titulli i pozitës:	ZYRTAR (ANALIST) I RISKUT
Orët e punës:	Orar i rregullt
Numri i referencës:	KON012025 (R)
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë e punës (njëvjeçare me mundësi vazhdimi)
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Vlerësimi i riskut për portofolet e investimeve të FKPK-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në risqet gjeopolitike, të palëve, çmimit/tregut, normës së interesit, valutës e të ngjashme.
- Organizimi dhe menaxhimi i raporteve të brendshme të riskut, formulimi i kontrollit të qëndrueshëm dhe sistematik të riskut dhe dokumentimi i proceseve.
- Mbështetja e proceseve të rishikimit të riskut dhe procedurave të tjera të lidhura me riskun.
- Përdorimi i matësve kryesore të industrisë dhe teknikave të riskut për të mbështetur vlerësimin e rreziqeve të investimeve të FKPK-së.
- Mbështetja e procesit të vendimmarrjes për investime, përmes analiza *ex-ante* për propozimet për investime.

Kandidati ideal do të:

- Ketë qasje praktike ndaj të gjitha çështjeve të lidhura me riskun dhe të krijojë një kuptim të shpejtë të strategjive dhe produkteve të investimit të FKPK-së.
- Ketë një njohje dhe interes për tregjet financiare, si dhe një kuptim solid të mjeteve dhe matësve të menaxhimit të riskut (p.sh. VaR, tracking error, volatility, beta, drawdowns) dhe konceptet për matjet kryesore të riskut.
- Aftësi analitike, të zgjidhjes së problemeve dhe të menduarit kritik, duke përfshirë aftësinë për të mbledhur dhe analizuar të dhënat e tregut.

Kriteret:

- Edukimi:** Master në ekonomi, financë, MBA në financë, matematikë.
Kujdes: Të diplomuarit jashtë Kosovës duhet ta kenë nostrifikuar diplomën në Kosovë.
- Përvoja:** Një (1) vit përvojë në menaxhim të investimeve ose menaxhimin e riskut investues.
- Referenca:** Së paku dy (2) referenca që dëshmojnë angazhimin/përvojën përkatëse profesionale.
- Përparësi do të kenë kandidatët me:**
- Përvojë me platformat *Bloomberg/Reuters*.
 - Përvojë në përdorimin e një gjuhe programimi (p.sh. *Python*) si një mjet modelimi dhe kërkimi statistikor.
 - Certifikime CFA, FRM ose certifikime të tjera të ndërlidhura me riskun e investimit.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur prej: **31 janarit e deri më 20 shkurt 2025 në 23:59 (CET).**
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Analist i riskut"**.
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: diplomat, biografia (CV), letërmotivimi dhe certifikatat profesionale në fushën përkatëse (nëse ka).

Informim paraprak:

- Aplikacionet që nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet e lartcekura NUK do të shqyrtohen! Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të kontaktohen.
- Kandidatët mund t'i nënshtrohen testimit për vlerësimin e aftësive të kërkuara.

FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!